



4 European
Union
Kosovo



STRATEGJIA E AVOKIMIT DHE PLANI I VEPRIMIT PËR DECENTRALIZIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE NË KOSOVË

2019-2021

Korrik, 2019





**STRATEGJIA E AVOKIMIT DHE
PLANI I VEPRIMIT PËR
DECENTRALIZIMIN E SHËRBIMEVE
SOCIALE DHE FAMILJARE NË KOSOVË**

2019 - 2021

Korrik 2019

Kjo strategji është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale, është prodhuar në kuadër të projektit “Aksioni i Përbashkët për Decentralizim” (Joint Action for Decentralization), financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga KOMF në partneritet me SOS, OFAP dhe KMOP.

Hyrje

Në rrethanat kur nuk kemi përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të sigurojë shërbime sociale dhe familjare duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat e tyre themelore bazuar në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Shërbimet sociale sipas legjislacionit në Kosovë janë të dizajnuara për t'ju shërbyer të gjithë qytetarëve në nevojë duke përfshirë: fëmijët pa përkujdesje prindërore, fëmijët dhe të rriturit viktimë të dhunës, abuzimit, keqtrajtimit, neglizhimit apo trafikimit, fëmijët e përfshirë në punë të rënda, fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, fëmijët në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale, personat e moshës së shtyrë, familjet me marrëdhënie të çrregulluara, fëmijët dhe të rriturit me varësi nga alkooli ose drogat, personat e prekur nga fatkeqësitë e shkaktuara nga natyra apo njeriu, ose personat që për ndonjë arsye tjetër i bën ata persona në nevojë për shërbime sociale.

Në vitin 2009 është bërë decentralizimi i shërbimeve sociale, ku janë bartur kompetencat nga niveli qendror (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) drejt komunave të Kosovës.

Pas decentralizimit, Komunitetet kanë përgjegjësinë të ofrojnë shërbime sociale, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familje. Kalimi i menaxhimit të shërbimeve sociale nga niveli qendror në nivelin lokal është bërë në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Financave dhe Komunave.

Megjithatë, procesi i decentralizimit po vazhdon të kalojë me shumë sfida, duke mos u realizuar ende plotësisht. Një ndër sfidat kryesore mbetet decentralizimi i buxhetit për shërbime sociale.

Në nivelin e Qeverisë qendrore, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është institucioni përgjegjës për të gjitha politikat, licensimin, monitorimin, inspektimin dhe çështjet rregullative në lidhje me punën dhe mirëqenien sociale.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka mandatin nga qeveritë komunale për të pasur përgjegjësinë mbi çështjet e mirëqenies sociale të komunave dhe bën menaxhimin e Qendrave për Punë Sociale (QPS). Nën këtë marrëveshje, shërbimet sociale janë në përgjegjësi komunale nën menaxhimin e Drejtorive Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DKSHMS), ndërsa skema e zgjeruar mbetet e centralizuar, shërbimet rezidenciale kanë mbetur nën kontrollin qendror të MPMS.

Shërbimet sociale janë kompetencë vetanake komunale dhe bazuar në Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal financohen nga komunitetet përmes dy burimeve të financimit nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake komunale. Mungesa e një granti specifik për shërbime sociale për komunitetet pamundëson ofrimin e shërbimeve cilësore minimale për mbrojtjen e fëmijëve dhe pengon mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre. Kjo i pamundëson këto institucione në përmbushjen e mandatit dhe obligimeve të parapara me legjislacionin në fuqi.

Për më tepër buxheti nuk merr për bazë faktorët bazë si numrin e popullatës, grupmoshat, apo kërkesën e shërbimeve komunale duke e bazuar në koston për shërbime, aq më pak nuk merr për bazë faktorët e rrezikut.

Në këtë drejtim, ka mungesë qartësie në mes komunave rreth buxhetit lokal të disponueshëm për shërbimet sociale, i cili ka rezultuar në ndryshime të konsiderueshme në nivelet e mbështetjes për ofrimin e shërbimeve sociale. Burimet financiare dhe kapacitetet njerëzore të kufizuara, si dhe mungesa e planifikimit të duhur rezultojnë në ofrimin e dobët të shërbimeve sociale për personat më të cenueshëm në Kosovë. Për më tepër, komunitetet nuk kanë të dhëna të sakta për numrin e popullsisë, të ndara sipas

gjinisë, grupmoshave, etnisë, aftësisë ose cënueshmërisë, dhe kjo ka ndikim negativ në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve.

Nëse vazhdohet me këtë formë të financimit gjendja mund të keqësohet për aq sa ta sjellë QPS-në në një qendër jofunksionale, e cila duke mos u financuar mjaftueshëm nuk do të mund të ofrojë shërbime sociale ose do të duhej të bënin kompromis me cilësinë e shërbimeve sociale dhe që në të dyja rastet, në rast të inspektimit bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale mund t'i merret e drejta e ushtrimit të kompetencës dhe kjo të kthehet në nivel qendror.

Përveç mungesës së vullnetit institucional dhe kapaciteteve për zbatimin e procesit të decentralizimit, përpjekjet e shoqërisë civile për të nxitur dhe avokuar për përfundimin e procesit kanë qenë dhe janë sporadike, të dobëta dhe jo të koordinuara për të rritur ndikimin dhe për të përsheptuar procesin. Shoqëria civile nuk ka qenë në gjendje të përfaqësojë plotësisht në mënyrë të koordinuar dhe t'i japë zë qytetarëve të cenuar në procesin e decentralizimit.

Decentralizimi nënkupton ndryshim në kulturën institucionale, duke krijuar një kontekst socio-politik që çon në transferimin e autoritetit dhe transferimin e financimit nga qeveria qendrore në qeverinë lokale për të siguruar ofrim cilësor dhe efektiv të shërbimeve. Prandaj është e rëndësishme të sigurohet që interesat e popullsisë të merren parasysh gjatë procesit të hartimit të politikave qendrore dhe zbatimit të tyre nga ana e autoriteteve lokale.

Me qëllim të përmbylljes së procesit të decentralizimit, KOMF përmes projektit “Aksioni i përbashkët për Decentralizim” projekt i financuar nga Bashkimi Europian dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, i cili implementohet nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF në partneritet me Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror (OFAP), SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP ka paraparë të zhvillojë strategjinë e avokimit dhe planin e veprimit për të fuqizuar organizatat anëtare, por edhe për të bashkërenduar ndërmarrjen e veprimeve avokuese që do të ndikojnë në përmbylljen e procesit të decentralizimit. Krahas veprimeve avokuese, KOMF do të zhvillojë një proces monitorimi i cili do rezultojë me publikimin e raporteve vjetore të monitorimit të cilat do të shërbejnë për të siguruar gjetje sa më të sakta sa i përket gjendjes aktuale dhe për të ofruar rekomandime konkrete për kompletimin e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale.

Metodologjia

Procesi i hartimit të strategjisë ka një vlerë të veçantë në gjithë fushën e avokimit drejt përmbylljes së procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale në Kosovë, andaj prezenca dhe kontributi i secilit anëtar të rrjetit por edhe aktorëve të tjerë të angazhuar në sferën e shërbimeve sociale, është parë të jetë shumë i nevojshëm në hartimin e strategjisë si dhe përcaktimin e veprimeve të përbashkëta avokuese.

Në procesin e ndryshimeve dhe plotësimeve të reformës ligjore për shërbime sociale dhe familjare, KOMF vazhdimisht ka qenë pjesë aktive për të ofruar qëndrimet dhe rekomandimet për këtë proces, ndaj përveç analizës së kornizës ligjore, dokumenteve dhe gjendjes aktuale në procesin e përmbylljes së decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare, KOMF së bashku me organizatat anëtare ka ofruar rekomandimet për mënyrën e financimit të shërbimeve sociale.

Gjatë hartimit të strategjisë për avokim përveç konsultimit dhe analizës së kornizës ligjore, dokumenteve aktuale si dhe praktikave rajonale, përmes punëtorive, punës me grupe të fokusuar si dhe përdorimit të instrumenteve janë identifikuar nevojat e anëtarëve për fushën e avokimit, përfshirja e palëve të interesit të cilat do të kontribuojnë gjatë hartimit të strategjisë së avokimit dhe zbatimit të saj.

Po ashtu në tërë procesin e identifikimit të nevojave dhe hartimit të strategjisë së avokimit KOMF ka përfshirë të gjitha organizatat anëtare të saj, OSHC-të e tjera, përfshirë përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kolegjiumi i asociacionit të komunave, Lidhja e qendrave për punë sociale, si dhe mekanizmat tjerë relevant në këtë proces. I gjithë ky rrjet do të kontribuojë në avokimin e përbashkët të tyre për çështjet relevante lidhur me procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

Përgjatë zhvillimit të punëtorive është përcaktuar Vizioni, Misioni, Akterët/palët e interesit, Objektivat strategjike; Audiencia; Mesazhet avokuese dhe Planin e veprimit. Çdo identifikim i bërë nga pjesëmarrësit në punëtori është analizuar përmes metodës RIPE (Relevante; e Rëndësishme; e Fuqishme; Potenciale) dhe metodës SMART (Specifike; e Matshme; e Arritshme; Reale; e kufizuar në kohë).

Teknikat dhe mjetet e përdorura kanë lehtësuar përcaktimin e përbashkët të Vizionit, Misionit dhe objektivave strategjike të cilat do lehtësojnë veprimet avokuese për përcaktimin e aktiviteteve avokuese në planin e veprimit.

VIZIONI

Shërbime sociale dhe familjare cilësore që sigurojnë mirëqënien e qytetarëve në nevojë sociale.

MISIONI

Në partneritet me palët e interesit do të kontribuojmë në përmbylljen e procesit të decentralizimit për shërbime cilësore sociale dhe familjare.

MESAZHI AVOKUES

Unë kam të drejtë në shërbime sociale!

Komuna ime, e drejta ime sociale!

Nevoja ime sociale, obligimi juaj ligjor!

Shënim: Mesazhet avokuese do të përdoren përgjatë zhvillimit të fushatave dhe veprimeve avokuese për të përçuar mesazhet jo vetëm tek palët e interesit por edhe tek publiku i gjërë.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

OBJEKTIVI 1: Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve dhe rolit aktiv të anëtarëve të KOMF, OSHC-ve të tjera dhe institucioneve qendrore dhe lokale drejt procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare

OBJEKTIVI 2: Avokimi drejt decentralizimit të shërbimeve sociale përmes kontributit në përmirësimin e kuadrit ligjor, monitorimit të legjislacionit dhe mobilizimit të institucioneve publike

OBJEKTIVI 3: Rritja e vetëdijësimit të opinionit të gjerë përmes komunikimit mediatik mbi decentralizimin e shërbimeve sociale dhe familjare

OBJEKTIVI 1

Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve dhe rolit aktiv të anëtarëve të KOMF, OSHS-ve të tjera dhe institucioneve qendrore dhe lokale drejt procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale

Përpyqjet e shoqërisë civile për të rritur ndikimin, për të përshpejtuar procesin e decentralizimit si dhe për të nxitur dhe avokuar për përfundimin e këtij procesi kanë qenë dhe janë sporadike, të dobëta dhe jo të koordinuara. Shoqëria civile nuk ka qenë në gjendje të përfaqësojë plotësisht dhe të i japë zë qytetarëve të cënuar në procesin e decentralizimit. OJQ-ve në përgjithësi ju mungojnë kapacitetet për të avokuar për përmbylljen e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale.

KOMF¹ është partneri më i qëndrueshëm për avokim, këshillim dhe negociata më Kryeministrinë, Qeverinë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kuvendin e Kosovës dhe mediat, duke përfaqësuar 29 OJQ të cilat punojnë në sektorin e mirëqenies, arsimit dhe shëndetit. Përvoja e mëhershme e KOMF në mbrojtjen sociale dhe mirëqenien sociale ka rezultuar me ndryshime pozitive dhe ndikim në shoqëri.

Përmes strategjisë së avokimit, të gjitha 29 organizatat anëtare të KOMF do të përfitojnë nga ngritja e kapaciteteve për avokim si dhe pjesëmarrje në dialog me vendim-marrësit sa i përket procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale. Për më tepër, për të gjitha organizatat që janë pjesë e KOMF, do të sigurohen që zëri i tyre, zëri i qytetarëve dhe grupeve më të cënuara në nevojë për mbrojtje sociale, të jetë i unifikuar dhe të dëgjohet nga trupat më të lartë të vendim-marrësve dhe autoriteteve.

Kjo strategji synon të fuqizojë KOMF, përfshirë 29 organizatat anëtare, pasi që ato janë pjesë e kësaj platforme dhe përmes kësaj strategjie, ato do të intensifikojnë dhe mbështesin avokimin drejt përfundimit të procesit të decentralizimit.

Rezultatet e pritshme:

1. Deri në vitin 2021, KOMF do të zgjerojë rrjetin me anëtarë dhe partnerë të rinj
2. Deri në vitin 2021, do të ngrihen kapacitetet avokuese të grupit për procesin decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare
3. Deri në vitin 2021, do të kontribuohet në përfitimin e përvojave profesionale, shkëmbimin dhe marrjen e praktikave me të mira
4. Deri në vitin 2021, anëtarët e rrjetit janë të informuar në vazhdimësi rreth procesit të decentralizimit
5. Deri në vitin 2020, do të identifikohen nevojat për mbështetje në së paku 5 komuna kryesore të Kosovës (me përfshirje regjionale)
6. Deri në vitin 2021, do të aktivizohen dhe marrin pjesë aktive institucionet në procesin e decentralizimit
7. Deri në vitin 2021, do të përfshihen drejtoritë komunale (drejtoria e shëndetësisë, arsimit, sociale, etj.)
8. Deri në vitin 2021 do të hartohet dhe ofrohet program i përbashkët i trajnimit

¹ <http://www.komfkosova.org/?lang=en>

Aktivitetet e planifikuara:

- 1.1. Identifikimi i organizatave joqeveritare dhe qeveritare të përfshira në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare
- 1.2. Trajnim për ngritjen e kapaciteteve avokuese të grupit për procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare (formave të avokimit për këtë proces, mentorime (online) nga ekspertët ndërkombëtare.
- 1.3. Vizitë studimore në shtetet me praktika të përfshirjes së OSHS-ve në procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale (Finlanda, Hungaria, Sllovenia, Kroacia...)
- 1.4. Takime informuese / Konferenca për shpërndarjen e vazhdueshme të informacionit rreth rrjedhës së procesit të decentralizimit në mes anëtarëve të rrjetit
- 1.5. Organizimi i punëtorive për identifikimin / prioritizimin e nevojave të komunave (QPS-ve dhe inst. të tjera) për mbështetje / ngritje të kapaciteteve bazuar në specifikat e komunës
- 1.6. Hartimi i programit të trajnimit të ngritjes së kapaciteteve që ofrohen nga grupi, për mbështetje të komunave rreth procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare në bazë të specifikave të komunës
- 1.7. Organizimi i punëtorive / trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të akterëve rreth procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare

OBJEKTIVI 2

Avokimi drejt decentralizimit të shërbimeve sociale përmes kontributit në përmirësimin e kuadrit ligjor, monitorimit të legjislationit dhe mobilizimit të institucioneve publike

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tanimë ka filluar procesin për hartimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, përderisa Ministria e Financave ka filluar plotësim ndryshim e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Ky objektivi do të mundësojë ngritjen e zërit të përbashkët të shoqërisë civile me qëllim të përmirësimit të situatës aktuale të decentralizimit, përmes hartimit të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare.

Kjo strategji do të mundësojë rrjetit të organizatave të shoqërisë civile (KOMF) që të jetë pjesë e hartimit të këtij Ligji dhe në të njëjtën kohë të avokojë për themelimin e Granit Specifik për Shërbime Sociale në kuadër të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, hartimin e formulës së financimit për shërbime sociale, të cilat janë komponente kyçe për të kompletuar procesin e decentralizimit.

Aktualisht ka një mungesë të monitorimit të pavarur nga shoqëria civile sa i përket zbatimit të procesit të decentralizimit.

KOMF do të bëjë monitorim vjetor mbi zbatimin e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale, në mënyrë që të rrisë përgjegjësinë e institucioneve publike ndaj qytetarëve.

Monitorimi i rregullt vjetor do të shërbejë për të siguruar një pamje të qartë lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor, identifikimin e dëshmive nga terreni si dhe dhënien e rekomandimeve për hapat e nevojshëm që përcaktojnë përfundimin e decentralizimit.

Rezultatet e pritshme:

1. Deri në fund të vitit 2019 do të dilet me qëndrim të përbashkët për Grant specifik
2. Qëndrimi me fokus në përcaktimin e indikatorëve social; Përfshirja e qëndrimeve në Ligjin për financat e Pushtetit lokal
3. Deri në fund të vitit 2019 do të promovohen qëndrimet e përbashkëta të rrjetit
4. Deri në fund të vitit 2020 do të hartohen rekomandimet për formulën e financimit me fokus rritjen e buxhetit
5. Deri në fund të vitit 2021 do të inkorporohen rekomandimet në formulën e financimit
6. Deri në fund të vitit 2020 do të hartohen qëndrimet/rekomandimet për hartimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare

Aktivitetet e planifikuara:

- 2.1. Punëtori me palët e interesit për hartimin e qëndrimeve të përbashkëta të rrjetit për Grantin Specifik dhe indikatorët social në kuadër të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal
- 2.2. Konferencë nacionale mbi qëndrimin e rrjetit për Grantin Specifik
- 2.3. Punëtori tematike rreth kostimit të shërbimeve dhe rekomandimeve
- 2.4. Takime/ Punëtori me vendimarrësit për inkorporimin e rekomandimeve të rrjetit në formulën e financimit (hartimi i akteve nënligjore)
- 2.5. Punëtori tematike për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare që prekin procesin e decentralizimit (kontributi në ligj)
- 2.6. Takime/ Punëtori me vendimarrësit për inkorporimin e rekomandimeve të rrjetit në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare
- 2.7. Monitorimi i procesit të zbatimit të decentralizimit (5 komuna, OJQ, rrjeti, partneret)

OBJEKTIVI 3

Rritja e vetëdijësimit të opinionit të gjerë publik përmes komunikimit mediatic mbi decentralizimin e shërbimeve sociale

Promovimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet e mirëqenies sociale përmes mediave mbetet një sfidë për shoqërinë civile. KOMF ka dëshmi se publiku i gjerë nuk ka informacion dhe vetëdije kolektive mbi procesin e decentralizimit dhe shërbimeve sociale. KOMF do të synojë fuqizimin e llogaridhënies nëpërmjet zhvillimit të ngritjes së vetëdijes në mesin e publikut të gjerë. Një angazhim më i madh do t'i kushtohet fuqizimit të kanaleve ekzistuese të komunikimit ndërmjet institucioneve, shoqërisë civile, medias dhe publikut. Fokusi kryesor do të jetë promovimi i mesazheve kryesore të shoqërisë civile për procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale përmes mediave. Kjo objektivë do të synojë rritjen e vetëdijësimit tek mediat, institucionet publike qendrore dhe lokale, partitë politike, bizneset, shoqërinë civile, institucionet diplomatike, agjencitë ndërkombëtare, prindërit, fëmijët dhe publikun e gjerë.

Kjo strategji gjithashtu do të kontribuojë për të bërë të dukshme shërbimet sociale përmes informimit adekuat, ndërgjegjësimin e publikut të gjerë dhe në të njëjtën kohë do të rrisë mbulimin mediatic dhe vëmendjen për mirëqenien sociale dhe shërbimet sociale.

KOMF do të udhëheqë shkëmbimin / bashkëpunimin e rregullt dhe sistematik me mediat, në lidhje me promovimin e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale. Më konkretisht, KOMF do t'i kushtojë vëmendje të veçantë dhënies së Çmimeve Vjetore për Gazetarët. KOMF gjithashtu do të organizojë dhe zhvillojë një fushatë kombëtare ndërgjegjësimi për të informuar dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për këtë çështje.

Rezultatet e pritura:

1. Deri në fund të vitit 2021 do të organizohen fushata mobilizuese
2. Deri në vitin 2021 akterët kyç do të informohen dhe përfshihen në procesin e decentralizimit
3. Deri në vitin 2021 do të avokohet në aktivizimin e asambleistëve komunal
4. Deri në vitin 2021 do të përfshihen përfituesit direkt në aktivitetet avokuese
5. Deri në vitin 2021 vendimmarrësit do të informohen dhe përfshihen në implementim të procesit të decentralizimit
6. Deri në vitin 2021 do të rritet raportimi mbi temat në fushën sociale

Aktivitetet e planifikuara:

- 3.1. Organizimi i fushatave mobilizuese për procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare
- 3.2. Organizimi i konferencës vjetore me institucione qendrore rreth procesit të decentralizimit dhe ndarjes së buxhetit në kuadër të formulës së financimit
- 3.3. Organizimi i konferencës vjetore me komunat për procesin e decentralizimit
- 3.4. Organizimi i konferencës për çmimet për gazetar
- 3.5. Organizimi i konferencës me çmimet për komunën që e ka implementuar me sukses procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare

Objektiva strategjike 1							
FUQIZIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE DHE ROLIT AKTIV TË ANËTARËVE TË KOMF DHE OSHS-VE TJERA DHE INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE LOKALE DREJT PROCESIT TË DECENTRALIZIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE							
Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Treguesi	Mjetet e verifikimit	2019	2020	2021	Organizata
1.1 Identifikimi i organizatave joqeveritare dhe qeveritare të përfshira në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare	1.Zgjerimi i rrjetit me anëtarë dhe partnerë të rinj	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i organizatave joqeveritare të reja të përfshira në grupe tematike • Numri i organizatave qeveritare të reja të përfshira në grup tematik 	<ul style="list-style-type: none"> • Lista e organizatave të përfshira në grupe tematike 	X	X	X	KOMF
1.2. Trajnim për ngritjen e kapaciteteve avokuese të anëtarëve për procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare (formave të avokimit për këtë proces, mentorime (online) nga ekspertet ndërkombëtare.	1.Ngritja e kapaciteteve avokuese të anëtarëve për procesin e decentralizimit	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i anëtarëve përfitues të trajnimeve • Numri i trajnimeve të ofruara • Numri i takimeve mentoruese që ofrohen për anëtarët 	<ul style="list-style-type: none"> • Listat e pjesëmarrësve • Foto • Raporte • Fletëvlerësime të trajnimeve 	X	X	X	KOMF KMOP
1.3 Vizitë studimore në shtetet me praktika të përfshirjes së OSHC-ve në procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale (Finlanda, Hungaria, Sllovenia, Kroacia...)	1.Përfitimi i përvojave profesionale, shkëmbimi dhe marrja e praktikave me të mira	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i pjesëmarrësve / Organizatave në vizitë • Numri i dokumenteve/praktikave të ndara/replikuara 	<ul style="list-style-type: none"> • Lista e pjesëmarrjes • Dokumentet e udhëtimit / vizitës • Foto • Raporti nga vizita • Dokumentet e mbledhura 		X		KOMF
1.4 Takime informuese/ Konferenca për shpërndarjen e informacionit rreth decentralizimit në mes anëtarëve të rrjetit	Anëtarët e rrjetit janë të informuar në vazhdimësi rreth procesit	<p>Së paku tri takime informuese në vit me anëtarët e grupit</p> <p>Dokumentet informuese ndahen vazhdimisht me anëtarët</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Lista e pjesëmarrjes • Foto • Letrat informative / Komunikatat 	X	X	X	KOMF

<p>1.5 Organizimi i punëtorive për identifikimin/ prioritizimin e nevojave të komunave (QPS-ve dhe inst. tjera) për mbështetje/ ngritje të kapaciteteve bazuar në specifikat e komunës</p>	<p>1. Nevojat e identifikuar për mbështetje në 5 komuna të Kosovës</p> <p>2. Pjesëmarrësit janë pajisur me mjete dhe dokumente relevante për ngritjen e kapaciteteve për të plotësuar nevojat e identifikuar</p> <p>3. Pjesëmarrja aktive e institucioneve</p> <p>4. Përfshirja e drejtorive komunale</p>	<p>5 ditëpunëtori janë mbajtur</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lista me nevojat e identifikuar • Numri i institucioneve që marrin pjesë 	<p>Listat e pjesëmarrësve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Foto 	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>KOMF</p>
<p>1.6 Hartimi i programit të trajnimit të ngritjes së kapaciteteve që ofrohen nga grupi, për mbështetje të komunave rreth procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare në bazë të specifikave të komunës</p>	<p>1. Programi i përbashkët të trajnimit i hartuar</p> <p>2. Lista e llojeve të trajnimeve që do të ofrohen</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Programi i trajnimit i hartuar • OJQ-të/Trajnerët e përcaktuar që mbajnë trajnimet 		<p>X</p>	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>KOMF</p> <p>Anëtarët e KOMF</p>
<p>1.7 Organizimi i punëtorive/trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të akterëve rreth procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare</p>	<p>1. Akterët janë pajisur me informata dhe njohuri rreth procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale</p> <p>2. Pjesëmarrja aktive e institucioneve</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i punëtorive të mbajtura • Numri i iniciativave të inicuar nga komuna 	<ul style="list-style-type: none"> • Pre / post pyetësorët • Raportet e trajnimit • Listat e pjesëmarrësve • Raportet e monitorimit • Foto 	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>X</p>	<p>KOMF</p> <p>OFAP</p> <p>Organizatrat anëtare</p>

Objektiva strategjike 2							
AVOKIMI DREJT DECENTRALIZIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE PËRMES KONTRIBUTIT NË PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR, MONITORIMIT TË LEGJISLACIONIT LOKAL DHE MOBILIZIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE							
Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Treguesi	Mjetet e verifikimit	2019	2020	2021	Organizata
2.1 Punëtori me palët e interesit për hartimin e qëndrimeve të përbashkëta të rrjetit për Grantin Specifik dhe indikatorët social në kuadër të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal	1.Qëndrimi për Grant specifik është unifikuar dhe validuar	• Dokumenti me qëndrime të përbashkëta të palëve të interesit	• Listat e Pjesëmarrjes • Fotot • Dokumenti i nënshkruar nga palët	X			KOMF
2.2 Konferencë informative nacionale mbi legjisllacionin që prek decentralizimin	1.Palët e interesit janë të informuar për qëndrimet e rrjetit për procesin e decentralizimit	• Numri i shtuar i përkrahësve të qëndrimeve të përbashkëta • Konferenca për media • Numri i lajmeve në Media	• Lista e Pjesëmarrjes • Fotot nga eventit	X	X	X	KOMF
2.3 Punëtori tematike rreth kostimit të shërbimeve dhe rekomandimeve për formulën e financimit	1.Qëndrimet për formulën e financimit janë unifikuar	• Numri i punëtorive të mbajtura • Qëndrimi i rrjetit	• Lista e pjesëmarrësve • Foto • Raporte	X	X		KOMF
2.4 Takime/ Punëtori me vendimarrësit për inkuorporimin e rekomandimeve të rrjetit në formulën e financimit (hartimi i akteve nënligjore)	1.Rekomandimet e rrjetit për formulën e financimit janë të inkuorporuara	• Numri i punëtorive të mbajtura • Dokumenti me rekomandime	• Lista e pjesëmarrësve • Foto • Raporte	X	X		KOMF
2.5 Punëtori tematike të rrjetit për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare që prekin procesin e decentralizimit (kontributi në ligjit)	1.Qëndrimet rrjetit për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare janë hartuar dhe unifikuar	• Numri i punëtorive të mbajtura • Dokumenti me rekomandime	• Lista e pjesëmarrësve • Foto • Raporte	X	X	X	KOMF
2.6 Takime/ Punëtori me vendimarrësit për inkuorporimin e rekomandimeve të rrjetit në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare	1.Rekomandimet e rrjetit për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare janë të inkuorporuara	• Numri i punëtorive të mbajtura • Dokumenti me rekomandime	• Lista e pjesëmarrësve • Foto • Raporte	X	X	X	KOMF

2.7 Monitorimi i procesit të zbatimit të decentralizimit (5 komuna, OJQ, rrjeti, partneret)	1.Gjendja mbi decentralizimin është e dokumentuar përmes monitorimit	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i vizitave monitoruese • Numri i intervistave të zhvilluara në komuna • Raporti i monitorimi 	<ul style="list-style-type: none"> • Termat e Referencës • Indikatorët • Pyetësorët • Raportet 	X	X	X	KOMF
Objektiva strategjike 3							
MBËSHTETJA E E INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE LOKALE SI DHE RITJIA E VETËDIJËSIMIT TË OPINIONIT TË GJERË PUBLIK PËRMES KOMUNIKIMIT MEDIATIK MBI DECENTRALIZIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE							
Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Treguesi	Mjetet e verifikimit	2019	2020	2021	Organizata
3.1 Organizimi i fushatave mobilizuese për procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare	1.Informimi, mobilizimi dhe vetëdijësi/aktivizimi është rritur për rëndësinë e procesit të decentralizimit	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i aktiviteteve avokuese • Prodhimi i materialeve promovuese • Prezenca në debate mediale 	<ul style="list-style-type: none"> • Lista e Pjesëmarrjes • Fotot nga eventit • Letrat informative / Komunikatat 		X	X	Platforma
3.2 Konferencë informative vjetore me institucione qendrore rreth procesit të decentralizimit dhe ndarjes së buxhetit në kuadër të formulës së financimit	1.Vendimmarrësit dhe palët e interesit janë të informuar dhe përfshirë në implementim të procesit të decentralizimit	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i përfaqësuesve pjesëmarrës në konferencë • Materialet e konferencës 	<ul style="list-style-type: none"> • Lista e Pjesëmarrjes • Fotot nga eventit • Letrat informative / Komunikatat 	X	X	X	Platforma
3.3 Konferencë informative vjetore me komunat për procesin e decentralizimit	1.Komunat janë të informuara dhe të përfshira në implementim të procesit të decentralizimit	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i përfaqësuesve pjesëmarrës në konferencë • Materialet e konferencës 	<ul style="list-style-type: none"> • Lista e Pjesëmarrjes • Fotot nga eventit • Letrat informative / Komunikatat 	X	X	X	KOMF
3.4 Çmimet për gazetarë	1.Rritja e raportimit mbi temat në fushën sociale	• 6 Çmime në vit janë ndarë	• Letrat informative / Komunikatat	X	X	X	KOMF
3.5 Çmimet /mirënjohjet për komunat që kanë implementuar me sukses procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale dhe familjare	1.Komunat i kushtojnë rëndësi dhe vëmendje më të madhe çështjeve sociale	<ul style="list-style-type: none"> • Termat e Referencës • Raporti i vlerësimit • Vendimi i panelit 	<ul style="list-style-type: none"> • Fotografitë • Mbulimi mediatik • Mirënjohjet 		X	X	KOMF

Procesi i hartimit të kësaj strategjie është mbështetur nga **SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë** përmes angazhimit dhe punës profesionale të ekspertës së avokimit, **Remzije Krasniqi**.

Për hartimin e kësaj strategjie, një falenderim i veçantë shkon për organizatat anëtare të KOMF dhe partnerët e tjerë, për përfshirjen e drejtpërdrejtë dhe kontributin e tyre të çmuar gjatë gjithë procesit:

- SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
- Organizata për fëmijët pa kujdes prindëror - OFAP
- ASTRA
- OPFAKKOS
- Qendra për Mbrojtje të Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit – QMVPT
- World Vision
- HANDIKOS
- Network of Peace Movement - NOPM
- Save the Children
- Organizata Rinore AKTI
- Terre des hommes
- Autizmi
- Down Syndrome Kosova
- Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN)
- Qendra Labyrinth
- Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS
- ChildProof - CIPOF
- Programi për të Drejtat Civile - CRPK
- Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët - SDSF
- Qendra për Arsim e Kosovës - KEC
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Institucioni i Avokatit të Popullit
- Asociacioni i Komunave
- Lidhja e Qendrave për Punë Sociale të Kosovës



European
Union
Kosovo